



Bazuar në nenin 5 dhe 6 të Rregullores së punës së Senatit të Universitetit të Prishtinës nr. 1/131 datë 1.6.2015, Rektori i UP-së thërret mbledhjen -XX-të, të Senatit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së Senatit të datës 14.10.2021;
2. Shqyrtimi i kërkesave për miratim të temës dhe aprovim të mentorit për kandidatët në studimet e doktoratës sipas raportit të KQSD për kandidatët nga njësitë akademike të UP-së;
3. Shqyrtimi i kërkesave për ratifikim të punimeve të doktoratës sipas raportit të KQSD për kandidatë nga Fakulteti i Filologjisë;
4. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për rritjen e numrit të studentëve në programin Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike Master në FIEK (Vendimi i AKA-së nr.3426/21D, datë 20.10.2021 për 40 studentë);
5. Shqyrtimi i kërkesës së FBV-së për lejimin e bartjes së studentëve nga departamentet tjera në të cilin kandidatët kanë arritur pikët e kalueshmërisë por nuk janë pranuar për arsye të plotësimit të vendeve, në departamentin Menaxhim biznesit në zooteknikë në të cilin nuk është plotësuar numri i studentëve sipas kriterëve të rregullores (provimi pranues ka qenë i njëjtë);
6. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për zgjedhjen e personelit të rregullt akademik sipas konkursit nr. 804, dt. 14.5.2021, (Fakulteti Filologjisë; F. Ekonomik; F. Mjekësisë, Fakulteti Edukimit Fizik dhe Sportit dhe F. Edukimit);
7. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet me pjesëmarrje fizike në Sallën e Senatit të UP-së, ditën e martë më datë 02.11.2021, në orën 10.00.

Vëmendje: Mbajtja e maskave është e obliguar.

Me rastin e hyrjes në amfiteatër, të gjithë të pranishmit duhet të posedojnë dhe prezantojnë ndonjërin nga dëshmitë si në vijim:

- Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një dozë të vaksinës kundër COVID-19;
- Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
- Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitropave serologjik - IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve;
- Testi shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë.



Kryesues i Senatit të UP-së

Prof.dr. Naser Sahiti, rektor